



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 12 mars 2014, në mbledhjen e I-rë (parë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.00.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht Afrim Shabani, Bahri Blakçori, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Islam Revuçi, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullhau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë dhe z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së.

Fillimisht z. Mehmet Gashi, kryesues i Komitetit, njoftoi për takimin konsultativ të mbajtur me shefat e Grupeve të këshilltarëve

1. Miratimi i rendit të punës

Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri me propozimin e kryesuesit që në pikën e rendit të ditës, Të ndryshme, të shqyrtohet shkresa e Asociacionit të Komunave të Kosovës për delegimin e përfaqësuesve të komunës së Podujevës në Kuvendin e Asociacionit të cekur.

2. Propozimi i Vendimit për themelimin e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit (Përveç Komitetit për Politikë dhe Financa i cili është themeluar)

➤ Komiteti për Komunitete

z. Naim Çunaku, theksoi, ne qëndrojmë për strukturën e komiteteve sipas marrëveshjes që është arritur në takimin konsultativ me përfaqësuesit e subjekteve politike, e në rastin konkret është që LDK, PDK dhe LVV të përfaqësohen me nga 1 anëtar ndërsa anëtarët tjerë të jenë nga komunitetet pakicë.

z. Haki Rudari, theksoi, e mbështes parafolësin, kolegun tim, dhe konsideroj se nuk kemi çfarë të diskutojmë për strukturën e komiteteve por duhet të përqendrohemi në propozimin e kandidatëve për komitetet përkatëse.

z. Islam Revuçi, theksoi, sa i përket strukturës së komiteteve dhe komisioneve në mënyrë unanime është arritur marrëveshja, andaj pajtohemi me parafolësin që të kalohet në propozimin e kandidatëve.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, pajtohemi sa i përket përfaqësimit të subjekteve politike mirëpo sa unë jam në dijeni në komunën e Podujevës nuk jetojnë pjesëtarë të komunitetit pakicë serb, ndërsa në strukturën e këtij Komiteti është paraparë edhe përfaqësuesi i komunitetit të cekur.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, struktura e Komitetit për Komunitete është propozuar plotësisht në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale ngase përfaqësimi në këtë Komitet bëhet mbi bazën e specifikave të përcaktuara me ligj.

Kuvendit, njëzëri, i rekomandohet përbërja, si në vijim:

LDK 1 anëtar – Shaban Osmani

PDK 1 anëtar –

LVV 1 anëtar – Bahri Selimi

Komuniteti ashkali 2 anëtarë

- Shaban Ahmeti
- Xhafer Ademi

Komuniteti rom 1 anëtar – Mefail Rama

Komuniteti serb 1 anëtar - Radisav Peroviq

Kryesuesi i Komitetit zgjedhet nga ky Komitet.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, jam i mendimit se nuk është e nevojshme që të debatohet për komitet vijuese veç e veç ngase për strukturën e tyre është arritur pajtueshmëri e plotë por mbetet vetëm të kalohet në propozimin e kandidatëve.

z. Naim Çunaku, u pajtua me parafolësin dhe shtoi, Grupi i këshilltarëve i PDK – së emrat e kandidatëve do t'i paraqet në mbledhjen e nesërme të Kuvendit.

Kuvendit, njëzëri i rekomandohet struktura e komiteteve, si në vijim:

Subjektet politike të cilat nuk i kanë paraqitur propozimet, propozimet përkatëse t'i paraqesin në mbledhjen e Kuvendit

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

LDK 3 anëtarë:

- Dr Zaim Thaçi
- Dr Ismet Jashari
- Afërdita Lutfiu

PDK 2 anëtarë

-
-
LVV 1 anëtar
-
AAK – LDD 1 anëtar
-
Kryesuesi i Komitetit nga radhët e PDK – së

Komiteti për Arsim dhe Kulturë

LDK 3 anëtarë :
- Kadrie Mulolli – Kryesuese e Komitetit
- Selman Hoti
- Nusret Ismajli
PDK 2 anëtarë:
-
-
LVV 1 anëtar:
-
Komuniteti pakicë 1 anëtar
- Jahë Lahu

Komiteti për Zhvillim Ekonomik

LDK 3 anëtarë :
- Agron Hyseni – Kryesues i Komitetit
- Avni Shabani
- Hasan Softolli
PDK 2 anëtarë:
-
-
LVV 1 anëtar:
-
AAK – LDD 1 anëtar

3. Propozimi i Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

z. Kadri Avdiu, theksoi, duke u bazuar në propozimin e këtij vendimi vërehet se janë disa emra për të cilët nuk kemi të dhëna se vërtet a janë propozuar prej strukturave përkatëse.

Ky Këshill ka qenë i themeluar edhe në mandatin e kaluar, por ka qenë në nivel të detyrës ngase nuk i ka trajtuar disa çështje të ndjeshme që kanë të bëjnë me sigurinë por edhe në asnjë rast në Kuvend nuk e ka paraqitur raportin e punës.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, sa për informim mund t’ju them se KKSB vitin e kaluar është shpallur Këshilli më funksional dhe për punën e mirë që ka bërë ka marrë mirënjohje nga Ministria e linjës.

z. Kadri Avdiu, parafolësit iu përgjigj, unë nuk jam në dijeni se ky Këshill a ka marrë apo prej kujt ka marrë mirënjohje, por jam në dijeni se në vitin 2013 njerëzit kanë bërë roje nëpër fshatra dhe lagje për shkak se brenda 7 ditësh janë thyer dhe vjedhur 22 shtëpi dhe nëse ndokush kësaj i thotë se siguria ka qenë në nivel unë nuk mund të them ashtu dhe nuk mund të pajtohem se Këshilli i përmendur ka qenë në nivel të detyrës kur përveç kësaj që e ceka ka munguar edhe komunikimi me qytetarë.

z. Haki Rudari, në parim jam për themelimin e KKSBB – së, mirëpo dëshiroj t'i ngriti dy çështje së pari më intereson të di për mënyrën se si personat përkatës janë propozuar në këtë Këshill, kuptohet përveç atyre që vijnë sipas funksionit të cilin e ushtrojnë dhe rezerva ime e dytë është për mënyrën se si është propozuar përfaqësuesi i komunitetit serb për të cilin duhet të informohemi se a është banor i komunës tonë dhe se a është bërë verifikimi i të kaluarës së tij.

Grupi i këshilltarëve i LVV – së nuk ka problem me emrat e kandidatëve por për ne vërejtja konsiston në atë se të propozuarit a e kanë përkrahjen e strukturave prej nga vijnë.

z. Islam Revuçi, theksoi, Udhëzimi Administrativ përkatës shumë qartë e parasheh mënyrën e themelimit të KKSBB – së dhe shtoi, nuk jam për atë që të debatojmë për punën e këtij Këshilli në të kaluarën mirëpo pajtohem plotësisht dhe është e drejtë t'i kërkohej këtij Këshilli që në periudha të caktuara t'i raportoj Kuvendit.

z. Naim Çunaku, theksoi, derisa Kuvendi i Komunës e themelon këtë Këshill është legjitime që në të ardhmen, në periudha të caktuara, t'i raportoj Kuvendit e një prej arsyeve për këtë është rasti mjaftë shqetësues që e përmendi z. Kadri Avdiu, rast për të cilin nuk jemi të informuar se a është shqyrtuar në këtë Këshill aq më tepër ngase dukuria e cekur është e shprehur dhe paraqet problem të theksuar në shumë fshatra.

Në mënyrë që të jemi më të përgatitur për mbledhjen e Kuvendit, kërkoj që Shërbimi profesional, pas përfundimit të kësaj mbledhjeje, të na e siguroj nga një kopje të udhëzimit Administrativ përkatës.

z. Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE – së, theksoi, kërkoj falje që e mora fjalën por qëllimi im është t'ju informoj se OSBE, vitin e kaluar, është përballur me kërkesën e komunitetit protestant me seli në Prishtinë, e cila ka të bëjë me përfshirjen e komunitetit të cekur fetar në përbërjen e KKSBB – së, kërkesë me të cilën sigurisht do të përballeni edhe ju ngase, sipas tyre, në komunën e Podujevës, i kanë rreth 30 pjesëtarë të komunitetit të cekur.

Një javë më parë, një zyrtar i lartë i imi më ka thirrur dhe më ka thënë se së shpejti do të vijë një përfaqësues i komunitetit protestant për të biseduar me mua lidhur me çështjen e cekur dhe përfundoi sigurisht brenda një kohe të shkurtër do të keni kërkesën e komunitetit të cekur fetar që të përfshihet në këtë Këshill.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, sipas mendimit tim nuk kemi çfarë të bisedojmë për anëtarët e këtij Këshilli të cilët vijnë sipas pozitive përkatëse, mirëpo anëtarët e tjerë mund të kontestohen dhe mund të debatohet për secilin prej tyre.

Gjithashtu mund të debatohet për punën dhe angazhimin e anëtarëve konkret në mandatin e kaluar dhe cilido që nuk ka qenë aktiv nuk do duhej të përfshihet në përbërjen e re të këtij Këshilli.

Propozimi im është që Kuvendit t'i rekomandohet shqyrtimi i këtij propozimi të vendimit, mirëpo listën e emrave përkatësisht atyre që nuk vijnë sipas pozitive përkatëse institucionale ta shqyrtojnë shefat e grupeve të këshilltarëve apo një komision i cili do të themelohej për këtë qëllim.

Gjatë diskutimeve u cek se ky Këshill nuk ka paraqitur raporte pune në Kuvend mirëpo nëse këtë nuk e ka bërë deri tash, tash e tutje duhet të paraqet raporte çdo tre apo gjashtë muaj.

z. Islam Revuçi, theksoi, në përbërjen e këtij Këshilli vijnë zyrtarët të cilët ushtrojnë pozita të caktuara në institucione të ndryshme, siç është rasti po e zëmë i zyrtares për barazi gjinore, pra për pozitën përkatëse nuk kemi çfarë të diskutojmë, mirëpo e marrim shembullin tjetër, po e zëmë përfaqësuesi i mediave lokale është z. Fadil Halimi, në rastet e kësaj natyre mund të shikojmë se a është bërë komunikimi zyrtar i nevojshëm dhe se kandidatët a janë propozuar nga strukturat përkatëse.

z. Haki Rudari, theksoi, në LVV në mënyrë absolute jemi kundër çfarëdo imponimi, mirëpo me këmbëngulje kërkojmë respektimin e procedurave për propozimin e kandidatëve, pra jemi për atë që propozimi i çdo kandidati të jetë i bazuar në ligj. Përndryshe kompetencë e Kuvendit të Komunës është që të diskutoj për çdo kandidatë.

Gjithashtu ne jemi të interesuar të na sqarohet se përfaqësuesi i komunitetit serb a është qytetar i komunës së Podujevës apo jo.

z. Naim Çunaku, theksoi, sot unë nuk e ndiej veten kompetent të flas për këtë çështje ngase nuk e kam lexuar Udhëzimin administrativ përkatës, i cili nëse jo të gjithë këshilltarëve së paku është dashur t'iu dërgohet shëfave të Grupeve të këshilltarëve.

z. Mehmet Gashi, kryesues, përmbylli debatin me konstatimet në vijim:

- Të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, pas përfundimit të mbledhjes, mund ta marrin Udhëzimin administrativ i cili e përcakton mënyrën e themelimit dhe përgjegjësitë e KKSB – së

- Për secilin kandidat të propozuar në KKSB, në Zyrën ligjore mund të shikohet dokumentacioni për bazën dhe mënyrën e propozimit të të gjithë kandidatëve.

- Komiteti i personave me nevoja të veçanta, në ndërkohë, e ka ndërruar kandidatin e tyre dhe në vend të z. Xhevat Kapitit, në formë të shkruar e ka dërguar propozimin tjetër dhe në këtë Këshill e propozon z. Idri Hoxhën.

- Sa i përket komunitetit fetar protestant, deri tash asnjë institucioni të Komunës, as në formë gojore e as në formë të shkruar, nuk i është bërë ndonjë kërkesë lidhur me çështjen të cilën e parashtoi përfaqësuesi i OSBE – së, mirëpo nëse paraqitet nevoja Vendimi për themelimin e KKSB – së mund të ndryshohet dhe plotësohet.

Pas votimit u konstatua se propozimi i këtij vendimi, në parim, Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

4. Propozimi i Vendimit për themelimin e Komisionit vlerësues për dhënien e pronave të paluajtshme në shfrytëzim

z. Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Naim Çunaku, theksoi, themelimi i këtij Komisioni është përcaktuar me dispozita ligjore, mirëpo duhet ta kemi të qartë se Komisioni i cekur themelohet në mandat të Kuvendit dhe se nuk e ka të drejtën e vendimmarrjes por çështjet i shqyrton dhe Kuvendit i paraqet propozimet përkatëse.

z. Islam Revuçi, theksoi, detyrat dhe përgjegjësitë e këtij Komisioni janë të përcaktuara me dispozita ligjore dhe shtoi, nga radhët e LDK – së, në këtë Komision, propozon z. Agron Hysenin.

Pas votimit u konstatua se propozimi i këtij vendimi, njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim me propozim që anëtarë të këtij Komisioni të jenë z. Agron Hyseni – LDK, z. Naim Çunaku – PDK, ndërsa LVV propozimin e paraqet në mbledhje të Kuvendit.

5. Propozimi i vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

z. Naim Çunaku, theksoi, është mirë që në dy vitet e fundit dhe në fillim përkatësisht vitin e parë të këtij mandati po praktikohet që të bëhet orari i mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit, mirëpo mangësia është se përveç orarit duhet të punohet dhe miratohet edhe plani i punës së Kuvendit për vitin përkatës, plan i cili në një masë të madhe duhet të mbështetet në planin e Ekzekutivit.

Në këtë kontekst propozimi im është që të mbështetet propozimi i këtij vendimi, por në një të ardhme të afërt të ngritet një grup punues dhe të përgatit propozimin e planit të punës së Kuvendit, pavarësisht se Ekzekutivi i komunës a do të merr pjesë apo nuk do të merr pjesë në këtë drejtim, këtë e them ngase Kuvendi dhe Ekzekutivi i kanë përgjegjësitë e ndara e nga kjo edhe sukseset, por sikur të dy palët të kishin planet e punës ky do të ishte sukcesi më i madh.

Këtë e potencova për faktin se në këtë mandat nuk kisha dashur të vazhdohet në veçanti pa planin e punës të Departamentit të prokurimit ngase ligjërisht Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e planit vjetor të prokurimit.

z. Mehmet Gashi, kryesues, u pajtua me propozimin e parafolësit dhe shtoi, unë e posedoj një model të mirë të planit të punës së Kuvendit, është një doracak i USAID – it i punuar me institucionet e Kosovës, në të cilën përveç tjerash është e përcaktuar edhe mënyra e hartimi, mirëpo ky plan duhet të miratohet para fillimit të vitit fiskal dhe nga kjo ne mund të ngritim një grup punues afërsisht në muajin tetor dhe ai plan të miratohet deri në fund të këtij viti në mënyrë që realizimi i tij të filloj vitin e ardhshëm.

Pas votimit u konstatua se propozimi i këtij vendimi, Kuvendit njëzëri i procedohet për shqyrtim me rekomandim që më së largu deri në tetor 2014 të ngritet një Komision për përgatitjen e Planit të punës së Kuvendit për vitin 2015 dhe të miratohet deri në fund të këtij viti.

6. Propozimi i vendimit për mbështetje financiare OJQ – në Handikos – Qendra e Rehabilitimit të Bazuar në Bashkësi në Podujevë

z. Kadri Avdiu, theksoi, do të ishte mirë që të na sqarohet se propozimi i këtij vendimi a ka të bëjë vetëm me shpenzime të administrimit apo ka të bëjë edhe me ofrimin e ndihmave të personave me nevoja të veçanta. Gjithashtu jam i interesuar të di se në kuadër të Handikos – it a përfshihen edhe shurdhmemecët dhe të verbërit.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, Handikos – i është OJQ – ja më e madhe e personave me nevoja të veçanta në komunën e Podujevës, andaj duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me një kategorinë më të ndjeshme të qytetarëve jam i mendimit se duhet të mbështetet propozimi i këtij vendimi.

z. kumrie Hoti, theksoi, ne gjithsesi jemi që të mbështetet propozimi i këtij vendimi, mirëpo jemi të interesuar të dimë se a është gjithëpërfshirës përkatësisht se në kuadër të kësaj OJQ – je a përfshihen të gjitha kategoritë e personave me nevoja të veçanta.

z. Afrim Shabani, theksoi, propozimi i vendimit është mjaftë i qartë sipas të cilit parashihet mbulimi i shpenzimeve për zhvillimin e aktiviteteve programore dhe objektivave të parapara për vitin 2014.

Kërkesa e Handikos – it ka të bëjë me mbulimin e shpenzimeve mëse të domosdoshme dhe duke u bazuar në këtë jam i mendimit se askush prej nesh nuk ka hezitim se a duhet të mbështetet apo jo dhe po ashtu jam i bindur se të gjithë ne jemi për atë që për këtë kategori të qytetarëve në vijimësi duhet të kemi kujdes të shtuar dhe gjithherë të ofrojmë ndihmën e mundshme.

z. Abaz Llugaliu, theksoi, mjetet financiare sipas propozimit të këtij vendimi kryesisht kanë të bëjnë me mbulimin e shpenzimeve për karburante dhe pagesën e qirasë ngase zyrat i kanë në një shtëpi private.

z. Naim Çunaku, theksoi, askush nuk e vënë në mëdyshje se a të mbështetet apo jo kërkesa e Handikos – it, Grupi i këshilltarëve i PDK – së fuqishëm e mbështet këtë kërkesë dhe është për atë që kjo OJQ, sipas mundësive, të ndihmohet në çdo formë të mundshme.

z. Kadri Avdiu, theksoi, në diskutimin e mëparshëm e shtrova një pyetje shumë të qartë se në këtë propozim vendim a janë të përfshira të gjitha kategoritë e personave me nevoja të veçanta, nëse po atëherë jam plotësisht i bindur se shuma e propozuar për mbështetje financiare është mjaftë e vogël dhe nuk i plotëson as afërsisht nevojat e personave të cekur.

z. Haki Rudari, theksoi, pajtohem me kolegun se secila kategori e personave me nevoja të veçanta e meriton të ndihmohet sipas mundësive që i kemi, ne Grupi i këshilltarëve i LVV – së fuqishëm e mbështesim kërkesën e Handikos – it dhe konsiderojmë se duhet të jemi gjithëpërfshirës dhe në mënyrë të përhershme t’iu ofrojmë ndihmat e mundshme.

z. Mehmet Gashi, kryesues, theksoi, kërkesa e Handikos – it ka të bëjë vetëm me mbulimin e shpenzimeve mëse të domosdoshme operative, duke u bazuar se kërkesa është mjaftë e arsyeshme po e vërej se disponimi i të gjithëve është që e njëjta të mbështetet.

Pas votimit u konstatua se propozimi i këtij vendimi, Kuvendit njëzëri i rekomandohet për miratim.

7. Të ndryshme

- Shqyrtimi i shkresës së Asociacionit të Komunave të Kosovës për Delegimin e përfaqësuesve të komunës së Podujevës në Kuvendin e Asocioacionit të cekur.

z. Mehmet Gashi, kryesues, njoftoi për shkresën e Asociacioni të Komunave të Republikës së Kosovës.

Pas dialogut të zhvilluar, propozimeve të paraqitura dhe vënies në votim u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet që në pikën të ndryshme, të miratohet Vendimi ku , përveç z. Agim Veliu Kryetar i Komunës, përfaqësues të Kuvendit të Komunës në Kuvendin zgjedhor të Asociacionit të Komunave të Kosovës, të jenë: z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, z. Liridona Shabani – LDK, z. Kadri Avdiu – PDK dhe Haki Rudari – LVV, me rekomandim që përfaqësuesit e cekur, në Kuvendin e AKK – së të shtrojnë çështjen e ngritjes së kompensimit të këshilltarëve të Kuvendeve të Komunave

Mbledhja përfundoi në orën 14.20’

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-28404
Podujevë,
12 mars 2014**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**